

UDHËZIM
Nr. 27, datë 26.11.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE PROFESIONALE 2020

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, germa “dh” dhe të nenit 8, germa “b”, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2020, për shkollat e mesme profesionale, të jenë:
- Provime të detyruara: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj dhe teori profesionale e integruar, sipas drejtimit/profilit që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.
2. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2020, të jenë:
 - a) gjuhë e huaj 8 qershor 2020
 - b) gjuhë shqipe dhe letërsi 11 qershor 2020
 - c) matematikë 15 qershor 2020
 - d) teori profesionale e integruar 18 qershor 2020
3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
4. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.
5. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019) që kanë rezultuar jokalue në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.
6. Lista e provimit të detyruar të teorisë profesionale të integruar sipas drejtimit/profilit që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale:

Nr.	Drejtimi/profili profesional
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike

21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut
26	Zhvillim <i>website</i> -i
27	Rrjete të dhënash (pilot-giz)
28	Inxhinieri informatike <i>software</i> -sh (<i>Hermann Gmeiner</i>)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (<i>Harry Fultz</i>)
34	Elektronikë (<i>Harry Fultz</i>)
35	Automekanik (<i>Harry Fultz</i>)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)

7. Provimet e detyruara gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj e parë dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

8. Provimet e detyruara të teorisë profesionale të integruar, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara në faqen e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

9. Kandidati, i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

10. Kandidati që në Maturën Shtetërore 2013–2016:

a) ka zgjedhur teorinë profesionale të integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje.

b) ka zgjedhur teorinë profesionale të integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e detyruar të teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, të cilat nuk përfshihet Teoria profesionale e integruar, duhet të japë provimin e detyruar të teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

11. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk ka dhënë provimin e Teorisë profesionale të integruar ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj